



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**

**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

Datë: 25 shkurt 2021

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafi 1.4 dhe nenit 5 paragrafët 2, 4, 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës dhe në bazë të Vendimit KPK/Nr.48/2021, të datës 25 shkurt 2021, shpall:

**KONKURS**

**Për emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë**

- I. Kandidatët e interesuar për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
- 1.1 Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
  - 1.2 Të mos ketë të ngritur aktakuzë;
  - 1.3 Të mos jetë i dënuar për vepër penale;
  - 1.4 Të ketë vlerësim pozitiv të performancës në tri vitet e fundit;
  - 1.5 Të mos ketë të shqiptuar sanksion disiplinor në pesë vitet e fundit, duke përjashtuar qortimin dhe vërejtjen jo publike;
  - 1.6 Të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral;
  - 1.7 Të plotësojë kriteret për emërim në Departamentin për të Mitur apo Departamentin për Krime të rënda të prokurorisë themelore.
- II. Kandidatët e interesuar për Kryeprokurorë të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, duhet të dorëzojnë:
- formularin për aplikim;
  - formularin për vetëvlerësim;
  - formularin e koncept dokumentit (janë të publikuara në ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës);
  - autobiografinë (CV);
  - certifikatën nga gjykata;
  - çfarëdo dokumenti tjetër relevant për të dokumentuar përvojën e tyre përfshirë rekomandimet;
- III. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon kandidatët e gjinisë femërore dhe kandidatët nga komunitetet jo shumicë që i plotësojnë kriteret e lartë cekura, që të aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.
- IV. Aplikacioni, së bashku me të gjitha dokumentet e bashkangjitura, duhet të dorëzohen nga data **1 mars 2021 deri më 15 mars 2021** te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e tretë (3) të ndërtesës së Prokurorit të Shtetit, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 306, të mbyllura në zarf, ose me postë.